

VENDIM
Nr. 150, datë 29.2.2012

PËR TRANSFERIMIN E PASURISË NR. 20/81, TRUALL, NË ZONËN KADASTRALE NR. 8502, NË PRONËSI TË BASHKISË SË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 8 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të bashkisë së Beratit të pasurisë nr. 20/81, truall, në zonën kadastrale nr. 8502, me sipërfaqe 7663 (shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre) m², pjesë e pronës nr. 1317, në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë e Beratit, sipas formularit dhe planvendosjes bashkëlidhur, për ngritjen e tregut industrial.

2. Bashkisë së Beratit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i bashkisë Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha